


sek-shërbimit Veterinar

KËRKESË PËR INFORMACION



12-05-2023

Nga: Znj. Diana Hila	Adresa postare: Rruga "Frosina Plaku", Kompleksi Kontakt, P. Lyra, Shk. 1, kati 10, Ap. 3, Tiranë Adresa elektronike: dianahila2002@yahoo.es Mobile: +355 (0) 69 24 02 294	Data: 12.05.2023 
--------------------------------	---	--

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Bazuar në kompetencat dhe detyrimet sipas Ligjit nr. 139/2015, për "Vetëqeverisjen vendore", të Ligjit Nr. 10.465, datë 29.09.2011, "PËR SHËRBIMIN VETERINAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", neni 54, gërma "c" dhe bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 230, datë 20.03.2013, "Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore", kapitulli VI, "MBIKËQYRJA DHE MBAJTJA NËN KONTROLL E QENVE DHE MACEVE ENDACAKE PA PRONARË", kërkoj nga ana juaj informacionet për:

1. Si është i organizuar shërbimi veterinar në bashkinë tuaj?
2. Sa veteriner janë në strukturën e shërbimit veterinar?
3. Sa është fondi i përcaktuar në buxhet për shërbimin veterinar në 5 vitet e fundit (specifikojeni sipas secilit vit)?
4. A keni hartuar program pune të profilaksisë veterinare në lidhje me situatën epizootike të qenve dhe maceve të rrugës, si edhe programe për kontrollin dhe lëvizjen e tyre?
- Nëse po, na e vendosni në dispozicion;
5. A i keni identifikuar qentë dhe macet e rrugës në territorin që administroni?
- Nëse po, sa është numri i tyre në 5 vitet e fundit?
(nëse i keni të ndara sipas muajve, njësive administrative, ju lutem specifikojeni);
6. Si e organizoni sterilizimin e organeve të riprodhimit të qenve dhe të maceve të rrugës?
7. Si i grumbulloni qentë dhe macet e rrugës?
8. A keni vende të posaçme, të miratuara, në të cilat i dërgoni?
9. Në cilat raste realizoni eliminimin e qenve dhe të maceve të rrugës dhe si e realizoni procesin?
- Nëse i keni eliminuar ato për arsyet që do i listoni, ju lutemi na informoni për numrin e qenve dhe maceve të eliminuar në 5 vitet e fundit (specifikojini sipas secilit vit);
10. A keni konstatuar raste ku ka pasur braktisje të qenve dhe maceve nga pronarët përkatës dhe çfarë masash keni marrë?

11. Çfarë masash keni marrë që në ambientet publike, si: rrugë, parqe, kënde lojërash etj., kafshët e shoqërimin të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose për kafshët e tjera?
12. Çfarë masash keni marrë për të vendosur dhe për të zbatuar në territorin që administroni, detyrimin për pronarët që të vendosin maskën mbrojtëse në gojë për qentë e shoqërimin të racave agresive gjatë qëndrimit të tyre në ambientet publike?
13. A keni konstatuar raste të helmimit të qenve dhe të maceve të rrugës?
- Nëse po, si keni vepruar në këto raste?
14. A keni referuar tek autoritetet ligjzbatuese raste të braktisjes, helmimit apo të vrasjes së qenve apo të maceve të rrugës?
- Nëse po, na informoni për secilin rast;
15. A keni informacion për sjelljen e maceve dhe kafshëve të rrugës nga territore të tjera të vendit në territorin e bashkisë suaj?
16. A keni marrë ankesa për mënyrën se si e menaxhoni situatën e maceve dhe të qenve të rrugës?
- Nëse po, na informoni për numrin e tyre në 5 vitet e fundit;
17. A keni ngritur qendra vaksinimi, kastrimi dhe sterilizimi për macet dhe qentë e rrugës?
Nëse po, na informoni për adresat e tyre dhe numrin e kafshëve të trajtuara, matrikulluara në 5 vitet e fundit, ndarë sipas kategorive, qen, mace, mosha, tipologjia, etj.;
18. A keni qendra të ngritura për macet dhe qentë e rrugës?
- Nëse po, si funksionojnë ato, a janë të përkohshme, të përhershme etj.?
- Si mundën qytetarët t'i vizitojnë qendrat tuaja dhe si e siguronit transparencën për punën tuaj?
19. A keni strehëza të përhershme të ngritura për macet dhe qentë e rrugës që janë në pritje të adoptimit?
- Nëse po, si funksionojnë ato?
20. Si funksionon adpotimi i qenve dhe i maceve të rrugës që ju i grumbulloni në territorin tuaj, nëse e ofroni këtë shërbim?

Të tjera të dhëna

- Kjo kërkesë dhe hartimi i saj bazohet në “Ligjin për të Drejtën e Informimit”, rrjedhimisht sqarojmë se pritja për një përgjigje nga institucioni juaj është 10 ditë, nëse ajo nuk kthehet, do t’i drejtohem Komisionerit për të Drejtën e Informimit;
- Ky informacion vjen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: Informacionin e kërkoj në rrugë elektronike, në formatin “Pdf” dhe jo të skanuar, sjellë në adresën elektronike: dianahila2002@yahoo.es

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: __/__/201__

Numri rendor i kërkesës:

Komente: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR, BUJQESISE DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT
SEKTORI I SHËRBIMIT VETERINAR DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT

Nr. 1725/1 Prot.

Gramsh me: 17/05/2023

Lenda: Kthim pergjigje shkreses Nr .1725 prot, date 12.05.2023

Drejtuar: Znj. Diana HILA

Rruga “Frosina Plaka”, Kompleksi Kontakt, P.Lyra Shkalla 1 kati 10 Ap. 3.
TIRANË

Në përgjigje suajës, regjistrua me tonën Nr. 1725 prot, date 12.05.2023 me lëndë: ”Kërkesë për Informacion “ ju bëjmë me dije si dhe ju përgjigjemi pyetjeve tuaja si më poshtë vijon:

1.Si është organizuar shërbimi veterinar në bashkinë tuaj?

Në bashkinë Gramsh shërbimi veterinar është organizuar në sektor më vete së bashku me Zyren e mbrojtjes së Konsumatorit.

2.Sa veteriner janë në strukturën e shërbimit veterinar?

Numri i veterinerëve përbëhet nga 2 punonjës.

3.Sa është fondi i përcaktuar në buxhet për shërbimin veterinar në 5 vitet e fundit (specifikojeni sipas secilit vit)?

Nuk ka për asnjë fond të specifikuar për sektorin e shërbimit veterinar.

4.A keni hartuar program pune të profilaksisë veterinarë në lidhje me situatën epizotike të qenve dhe maceve të rrugës si edhe programe për kontrollin dhe lëvizjen e tyre.

Nuk disponojmë program pune specifike të profilaksisë veterinarë në lidhje me situatën epizotike të qenve dhe maceve të rrugës si edhe programe për kontrollin dhe lëvizjen e tyre.

5.A keni identifikuar qentë dhe macet e rrugës në territorin që administroni.

-Nëse po sa është numri i tyre në 5 vitet e fundit.

Vazhdimisht ushtrojmë kontrole për identifikimin e tyre i cili relativisht varion 35-50 numri i tyre.

6.Si e organizoni sterilizimin e organeve të riprodhimit të qenve e maceve të rrugës?

Nuk kryejmë një proces të tillë.

7.Si i grumbulloni qentë dhe macet e rrugës?

Nuk kryejme grumbullim te qenve e maceve të rruges.

8.A keni vende të posaçme të miratuara në të cilat i dërgoni?

Nuk disponojm vende të posaçme të miratuara.

9.Në cilat raste realizoni eliminimin e qenëve e të maceve të rrugës dhe si e realizoni procesin?

Eliminimin e qenëve e të maceve të rrugës e realizojme vetem ne rastet kur shfaqin agresivitet tek njerzit. Eliminimi kryhet vetem me metoden e Eutenazise.

Nukemi patur raste te eliminimit te tyre gjate 5-vitet e fundit.

10.A keni konstatuar raste ku ka pasur braktisje të renve dhe maceve nga pronarët përkatës dhe çfar masash keni marrë?

Raste kemi konstatuar por nuk kemi arritur te identifikojme pronaret e tyre qe i kane braktisur.

11.Çfar masash keni marrë që në ambientet publike, si rrugë, parqe, kënde lojrash etj, kafshët e shoqerimit të mos paraqesin rrezik për njerzit dhe kafshët e tjera?

Ushtrrojme kontrolle të vazhdueshme ne keto ambiente dhe keshillojme vazhdimisht pronaret qe mbajne kafshe shoqerimi.

12.Çfar masash keni marrë për të vendosur dhe për të zbatuar në territorin që administroni, detyrimin për pronarët që të vendosin masken mbrojtese ne goje për qentë e shoqërimit të rracave agresive gjatë qëndrimit të tyre në ambientet publike?

Keshillim i vazhdueshem i pronarve te kafsheve te rracave agresive per vendosjen e maskes gjate qendrimit te tyre ne ambientet publike.

13.A keni konstatuar raste të helmimit të qenëve dhe maceve të rrugës?

-Nëse po si keni vepruar në këto raste.

Kemi konstatuar raste sporadike ku kafshet i kemi gjetur te ngordhura te dyshuara te helmuaara por te pa egzaminuara me analiza laboratorike.

14.A keni referuar te autoritetet ligjzbatuese raste të braktisjes, helmimit apo të vrasjes së qenëve dhe maceve të rrugës?

-Nëse po na informoni për secilin rast.

Nuk kemi referuar te autoritetet ligjzbatuese raste të braktisjes, helmimit apo të vrasjes së qenëve dhe maceve të rrugës pasi nuk kemi pasur nje informacion të saktë për këte gjë.

15.A keni informacion për sjelljen e maceve dhe kafsheve të rrugës nga territore të tjera në territorin e bashkisë tuaj?

Kemi pasur informacione anonime te pa identifikuara nga burime te ndryshme por jo te sakta dhe zyrtare per sjelljen kafsheve të rrugës kryesisht qen nga territore të tjera ne territorin tone.

16.A keni marre masa per menyren se si e menaxhoni situatën e qenëve dhe maceve të rrugës?

-Nese po na informoni për numrin e tyre në 5 vitet e fundit?

Ne vazhdimisht mbikqyrim dhe mbajme ne kontroll situaten per sjeljen e kafsheve të rrugës duke keshilluar banoret qe te tregojne kujdes per femijet grate dhe te moshuarit kur konstatojme qe ka ne periudha te caktuara kohore sidomos gjate shumezimit te tyre dhe duke identifikuar per cdo rast shfaqjen e kafsheve agresive.

17.A keni ngritur qendra vaksinimi, kastrimi dhe sterilizimi për macet dhe qentë e rruges?

Nuk kemi qendar te tilla per shkak te pamjaftueshmerise se fondeve buxhetore .

18.A keni qendra të ngritura për macet dhe qentë e rruges?

-Nëse po si funksionojnë ato dhe a janë të përkoshme, të përhershme etj?

Si munden qytetarët ti vizitojne qendrat tuaja dhe si e siguroni transparencën per punën tuaj?

Nukemi qendra te ngritura.

19.Akeni strehëza të përhershme të ngritura për për macet dhe qentë e rruges që janë në pritje të adoptimit?

-Nëse po si funksionojnë ato.

Nukemi strehëza të perhershme të ngritura.

20.Si funksionon adoptimi i qenëve dhe i maceve të rruges ju i gumbulloni në territorin tuaj, nese e ofroni kë shërbim?

Nuk e realizojme këtë shërbim.

Ju faleminderit per bashkepunimin.



Konceptoi: Xh.Lleshi

Konfirmoi: E.Koci

Miratoi: F.Lleshi

Dosja:

Afati: